

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Služba Kosova/Kosovo Correctional Service
Drejtoria Përgjithshme

SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS

Raport vjetor i punës

2023



Shërbimi Korrektues i Kosovës

Publikuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	3
Fjala hyrëse nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës	4
<i>Vizitat me rendësi të veçantë</i>	5
I. PJESA E PARË	8
Përmbledhje Ekzekutive	8
II. PJESA E DYTË	10
VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	10
Transparenca	10
III. PJESA E TRETË	11
ÇËSHTJET LIGJORE	11
Aktet nënligjore të miratuara	11
Projekt aktet nënligjore	12
Vizita në institucionet korrektuese lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit:	12
Kërkesat për faljen e dënimit:	12
Kërkesa për pezullim dënimit:	12
Kërkesa për ekstradim dhe transferim:	13
Përgjigje në rekomandimet e raporteve të avokatit të popullit.....	13
Menaxhimi i parasë publike-buxhetit të SHKK-së.....	14
IV. PJESA E KATËRT	15
Prokurimi	15
Menaxhimi i Parave Private të burgosurve (PPB-së)	15
V. PJESA E PESTË	17
Divizioni i Burimeve Njerëzore	17
Rekrutimet	17
Degradimet	17
Pensionimet	18
Masat disiplinore të shqiptuara ndaj personelit	18
Menaxhimi i sistemit të deklarimit të Pasurisë	18
Zhvillimi profesional i stafit	18
Kontributi i njësisë korrektuese të Eulex-it	22
VI. PJESA E GJASHTË	22
INXHINIERINGU	22

LISTA E SHKURTESAVE

SHKK-Shërbimi Korrektues i Kosovës

QK-Qendra Korrektuese

QP-Qendra e Paraburgimit

BSL-Burgu i Sigurisë së Lartë

QKFL-Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan

QKML-Qendra Korrektuese për të mitur në Lipjan

QEKL –Qendra Edukuese Korrektuese Lipjan

NJPB Nga Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve

MPPB Menaxhimi i parave private të burgosurve

NJVKB Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve

QAP Qendra për Aftësim Profesional

APRK Agjencioni i Punësimit të Republikës së Kosovës

FJALA HYRËSE NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM I SHËRBIMIT KORREKTUES TË KOSOVËS



Ismail Dibrani
Drejtore i Përgjithshëm

Kam nderin dhe kënaqësinë, që në kuadër të transparencës me publikun, të paraqes raportin vjetor të punës së Shërbimit Korrektues të Kosovës për vitin 2023.

Në këtë raport jepen të dhëna të detajuara mbi aktivitetet dhe veprimtaritë e punës një (1) vjeçare të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport pasqyrojnë angazhimin tonë maksimal në përmbushjen e detyrimeve si dhe identifikimin e fushave të caktuara ku nevojitet rritja e kapaciteteve tona me qëllim të ngritjes së performancës së punonjësve të SHKK-së.

Gjatë vitit 2023 SHKK ka qenë e përkushtuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve përmes trajnimeve të ndryshme profesionale, vizitave studimore, seminareve, punëtorive etj.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve njerëzore këtë periudhë SHKK-ja ka rekrutuar 50 zyrtare korrektuese dhe është në proces të rekrutimit edhe për 70 zyrtarë korrektues.

Vlen të theksohet se SHKK përmes aktiviteteve dhe programeve të ndryshme, krahas mbrojtjes dhe të drejtave të burgosurve, është përpjekur që të kontribuoj në rehabilitimin dhe risocializimin e personave që kanë rënë ndesh me ligjin për re integrim të suksesshëm në shoqëri.

Falënderoj stafin e Shërbimit Korrektues të Kosovës për kontributin e dhënë si dhe për punën e pa lodhshme në vazhdimësi për përmbushjen e misionit tonë të përbashkët.

Falënderoj po ashtu për mbështetjen e pa kursyer Kabinetin e Ministres, Ambasadën Amerikane në Republikën e Kosovës, Misionin e Eulex-it në Kosovë, Misionin e OSBE-së, Këshillin e Evropës, Mediat në Republikën e Kosovës si dhe të gjitha organizatat vendore dhe ndërkombëtare që në vazhdimësi kanë mbështetur Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Si SHKK jemi çdo herë të hapur për bashkëpunim me të gjithë duke synuar kështu që të përmbushin plotësisht misionin tonë për risocializim dhe ri integrim të personave të privuar nga liria si dhe duke ofruar siguri për gjithë shoqërinë.

Vizitat me rendësi të veçantë

Gjatë vitit 2023 Drejtori i Përgjithshëm i SHKK Ismail Dibrani ishte pjesëmarrës në konferenca dhe vizita zyrtare të cilat ishin të rëndësishme për forcimin e sistemit të burgjeve, si dhe për trajtimin dhe rehabilitimin e personave të dënuar të cilët mbahen në Institucione Korrektuese të Kosovës.



Vizita ne SHBA.

Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së z. Ismail Dibrani dhe Drejtori i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve, Dr. Milazim Gjocaj, se bashku me stafin korrektues dhe shëndetësor të Institucionit për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta kanë qëndruar në SHBA, përkatësisht në Departamentin e Shtetit, si dhe institucionet të kësaj natyre në Shtetin Pennsylvania.

Delegacioni ka zhvilluar dy takime të ndara me Drejtorin e Zyrës së Antiterrorizmit, për Evropë dhe Azi dhe udhëheqësit e INL (The International Narcotics and Law Enforcement Affairs Office), z. James Applegate, Drejtor Regjional për Evropë dhe Azi, dhe z. Andrew Horm, INL Kosovë.



Vizita në Gjermani.

Në Berlin të Gjermanisë është mbajtur konferenca e 12-të e Asamblesë së Përgjithshme e Drejtoreve të Burgjeve të Evropës. Shërbimi Korrektues i Kosovës ka nisur fazën e konsultimeve për anëtarësim në këtë Organizatë. Gjatë punimeve të asamblesë Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së z, Ismail Dibrani ka takuar Drejtorin e Shoqatës ndërkombëtare të Burgjeve (ICPA) z, Peter Severin, i cili ka përgëzuar Kosovën për sukseset e arritura dhe trajtimin sipas rregullave ndërkombëtare të burgjeve të personave që mbahen në institucionet korrektuese të Kosovës si dhe janë zotuar për thellimin e bashkëpunimit në të ardhmen.



Vizita në Hungari.

Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së z. Ismail Dibrani bashkë me zv. Drejtorin, z. Sami Gashi dhe delegacionin nga SHKK kanë qëndruar në Hungari për të marrë pjesë në një vizitë të rëndësishme, e cila kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit në fushën e sistemit të burgjeve.

Gjatë vizitës, u zhvilluan takime të ndryshme në të cilat u adresuan sfidat dhe të arriturat e të dyja vendeve, ku ndër të tjera u diskutua edhe për gjetjen e zgjidhjeve më të mira për zhvillimin e sistemit të burgjeve.

*Konferencën Ndërkombëtare të Burgjeve
International Corrections and Prisons Association (ICPA)*



Drejtori i Përgjithshëm, z. Ismail Dibrani ishte pjesëmarrës në Konferencën Ndërkombëtare të Burgjeve/ International Corrections and Prisons Association (ICPA), e cila u zhvillua në Antwerp të Belgjikës.

Ai e përfaqësoi Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe ndau eksperiencën dhe praktikën më të mirë në zhvillimin e sistemit korrektues.

Në këtë konferencë, u adresuan çështje të rëndësishme për fushën e korrektimit, duke përfshirë rehabilitimin e të dënuarve, sigurinë në burgje, si dhe përdorimin e teknologjisë në institucionet korrektuese.

I. PJESA E PARË

Përmbledhje Ekzekutive

Raporti i Punës për vitin 2023 paraqet veprimtarinë e zhvilluar të Shërbimit Korrektues të Kosovës në kuadër të mandatit ligjor, si institucion i pavarur i sigurisë në ushtrimin e funksioneve të veta.

- 1) Ky raport përbëhet nga aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit 2023, të cilat pasqyrojnë të arriturat e Shërbimit Korrektues, me ç ‘rast në pjesën e parë janë paraqitur misioni, vizioni, statusi dhe fushëveprimi i Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- 2) Në pjesën e dytë paraqitet vështrimi i përgjithshëm dhe transparenca.
- 3) Në pjesën e tretë tek çështjet ligjore është paraqitur hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore.
- 4) Pjesa e katërt pasqyron menaxhimin e parasë publike/buxhetin e SHKK-së, aktivitetet e prokurimit si dhe menaxhimin e parave private të burgosurve.
- 5) Në pjesën e pestë janë paraqitur aktivitetet nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Shërbimit Korrektues të Kosovës, si: rekrutimi, avancimi i personelit, masat disiplinore si dhe zhvillimi profesional i stafit.
- 6) Pjesa e gjashtë paraqet përmirësimin e kushteve të infrastrukturës për akomodim të burgosurve si dhe projektet e realizuara dhe të monitoruara nga zyra e inxhinieringut.
- 7) Pjesa e shtatë përfshinë aktivitetet dhe projektet e realizuara në Teknologjinë Informativë në SHKK.
- 8) Në pjesën e tetë përfshihet Njësia për Inteligjencë, menaxhimi i të burgosurve për vepra lidhur me terrorizëm, siguria në institucionet korrektuese, si dhe Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve.
- 9) Në pjesën e nëntë janë paraqitë programet dhe aktivitetet për rehabilitimin dhe risocializimin e të burgosurve si: programet rehabilituese, arsimimi i të burgosurve, programet trajnuese, punësimi, si dhe aktivitete tjera që kanë të bëjnë me risocializimin e të burgosurve.
- 10) Në pjesën e dhjetë është paraqitur Njësia Ekonomike.
- 11) Në pjesën e njëmbëdhjetë janë paraqitur statistika të ndryshme të mbledhura nga Qendra Operative e SHKK-së.
- 12) Në pjesën e dymbëdhjetë janë paraqitë donacionet e pranuar gjatë vitit 2023 nga institucionet dhe OJQ të ndryshme si dhe bashkëpunimet me ta.

Misioni

Misioni i Shërbimi Korrektues i Kosovës është të siguroj prezencën dhe mirëqenien e personave të privuar nga liria të cilët mbahen në Institucionet Korrektuese, të korrektoj dhe risocializoj të burgosurit duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa diskriminim si dhe përgatitjen e tyre për jetë në liri si persona të dobishëm për rrethin shoqëror në përgjithësi.

Vizioni

Të promovojë një shoqëri të drejtë dhe të sigurt nëpërmjet menaxhimit efikas dhe efektiv të shkelësve dhe administrimit të drejtësisë.

Statusi

SHKK është Agjenci Ekzekutive e Sigurisë cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe ka shenjën identifikuese, uniformën, flamurin dhe emblemën.

Fushëveprimi sipas ligjit:

- Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e burgimit të miturve dhe masave edukuese në IK përveç nëse Kodi i Drejtësisë për të Mitur e parashih ndryshe Zbatimin e masës së paraburgimit sipas Kodit të Procedurës Penale;
- Ndërmarrjen e masave të sigurisë për të ofruar ambient të sigurt dhe të përshtatshëm për jetë dhe punë;
- Ndërmarrjen veprimeve për ruajtjen e rendit, disiplinës dhe mbrojtjes së pronës në institucionet korrektuese të SHKK-së;
- Vlerësimin e rrezikut dhe nevojave për trajtimin e të burgosurve;
- Planifikimin, organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e programeve që i kontribuojnë risocializimit të burgosurve;
- Nxitjen, motivimin dhe zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive punuese për të burgosur;
- Zhvillimin e aktivitetit ekonomik dhe krijimin e të ardhurave përmes njësisë ekonomike të SHKK-së;
- Motivimin dhe krijimin e mundësive për arsimim dhe aftësim profesional për të burgosurit;
- Zhvillimin profesional të personelit të SHKK-së;
- Realizimin e bashkëpunimit me institucionet përkatëse dhe organizatat të cilat merren me çështjen e monitorimit e të drejtave të burgosurve;
- Udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar lidhur me planin e ri integritetit pas lirimit;
- Përbushjen e obligimeve tjera sipas legjislacionit në fuqi.

II. PJESA E DYTË

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Shërbimi Korrektues i Kosovës ka përmbushur obligimet e saj me profesionalizëm dhe integritet, duke u bazuar në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Ligjin për Shërbimin Korrektues të Kosovës aktet nënligjore, rregullat e brendshme, legjislacionin tjetër në fuqi, standardet ndërkombëtare si dhe prioritetet e planit të punës së SHKK-së.

Shërbimi Korrektues i Kosovës gjatë kësaj periudhe, ka arritur të kryej një varg aktivitete të fushëveprimit të saj dhe sipas vlerësimit ka shënuar progres në përmbushjen e objektivave të punës si dhe ka qenë transparent për mënyrën e ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësi që kemi ndaj të burgosurve, stafit dhe shoqërisë.

Shërbimi Korrektues i Kosovës me kapacitetet e saj të burimeve njerëzore është angazhuar dhe me përkushtim maksimal profesional për të përmbushur misionin për risocializimin e personave që kanë rënë ndesh me ligjin, duke mbikëqyrur ligjshmërinë e punës për ngritjen e cilësisë të trajtimit, respektimin e dinjitetit njerëzor dhe të drejtat fundamentale të personave të privuar nga liria, përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës dhe akomodimit në kuadër të mundësive buxhetore dhe me mbështetje nga donatorët si partner strategjik të SHKK-së.

Drejtori i Përgjithshëm ka përfaqësuar Shërbimin Korrektues të Kosovës në të gjitha proceset brenda dhe jashtë vendit.

Zv. Drejtorët e Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme si dhe Institucionet Korrektuese në kuadër të përgjegjësi, kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme për të arritur objektivat e parapara për vitin 2023.

Transparenca

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies Shërbimi Korrektues i Kosovës ka qenë vazhdimisht i përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, mediat elektronike dhe ato të shkruara.

Ky parim i transparencës përmban jo vetëm një detyrim për të ofruar informacion, por edhe për të garantuar qasje të lire dhe të lehtë për të gjetur dhe kuptuar këtë informacion për të gjithë të interesuarit.

Gjatë vitit 2023 janë realizuar 73 përgjigje në kërkesa të mediave, janë pranuar katër kërkesa për Qasje në Dokumente Publike, prej tyre, tri janë aprovuar dhe një është refuzuar.

Me leje të menaxhmentit të SHKK-së, nëpër institucionet korrektuese janë realizuar 19 programe televizive, janë publikuar 150 komunikata me shkrim për media, të njëjtat janë publikuar në ueb faqe dhe në rrjetet sociale të SHKK-së. Po ashtu, është përgatitur dhe publikuar një dokumentar për SHKK-në me rastin e 24 vjetorit të themelimit të SHKK-së.

III. PJESA E TRETË

ÇËSHTJET LIGJORE

Në bazë të planit të punës së Departamentit Ligjor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Planit të punës së Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2023, janë ndërmarr veprime me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe kryerjes së detyrave me përgjegjësi dhe ka arritur që të jap mbështetjen e nevojshme ligjore për funksionimin efikas të SHKK-së dhe në këtë raport vjetor prezantohen të arriturat vijuese:

Obligimet e hartimit të akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, andaj Departamenti ligjor ka planifikuar dhe ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme dhe i ka hartuar projekt udhëzimet administrative për të kompletuar legjislacionin sekondar. Gjatë vitit 2023 është arritur të miratohen aktet nënligjorë si në vijim:

Aktet nënligjore të miratuara

- Vendimi-për listimin e mjeteve kufizuese dhe pajisjeve tjera të sigurisë të lejuara për Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëzimi Administrativ për Kushtet dhe Procedurat e Veçanta për dhënien e lejes për të dënuarit që të punojnë jashtë institucioneve korrektuese;
- Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese;
- Udhëzimi Administrativ për Standardet dhe Kushtet Higjiena - Sanitare;
- Udhëzimi Administrativ për Beneficionet e Personave të Dënuar;
- Udhëzimi Administrativ për Funkcionalizimin e Qendrës për Vlerësim dhe Klasifikimin;
- Udhëzimi Administrativ Për Funkcionalizimin e Njesisë së Inteligjencës;
- Udhëzimi Administrativ për Procedurën për Punësimin e të Dënuarve, Pezullimin dhe Lirimin e të Dënuarve nga Puna;
- Udhëzimi Administrativ për Shpërblimin Mujorë për Punën e Personit të dënuar;
- Udhëzimi Administrativ për Funkcionalizimin e Njesisë Ekonomike;
- Udhëzimi Administrativ për Themelimin, Shuarjen apo Ndryshimin e IK;
- Udhëzimi Administrativ për Funkcionalizimin e NJPB;
- Rregulla e brendshme për Tretmanët për të Dënuar;

Projekt aktet nënligjore

Janë hartuar në 2023 dhe janë në procedurë të miratimit për vitin 2024 projekt aktet në vijim:

- Projekt rregulloren për organizimin e brendshëm të SHKK-së;
- Projekt Udhëzimi Administrativ për Procedurën, Klasifikimin dhe Shqiptimin e Dënimeve Disiplinore për Personat e Dënuar;
- Projekt Udhëzimi Administrativ për Ushqimin e Personave të Burgosur;
- Projekt Udhëzimi Administrativ për Mbajtjen dhe Grumbullimin e Evidencave për Personat ndaj të cilëve Ekzekutohen Sanksionet Penale;
- Projekt Udhëzimi Administrativ lidhur me të Dhënat e Personit që Gjendet në Paraburgim;
- Projekt Udhëzimi Administrativ për Procedurat dhe Kushtet për Gradim të Zyrtarëve Korrektues;
- Projekt Udhëzimi Administrativ për Kushtet e Punës, duke Përfshirë edhe Kompensimin në rast të Paaftësisë për Punë;
- Projekt Udhëzimi Administrativ për Procedurat dhe Shqiptimin e Masave Disiplinore për Personelin e SHKK-së;

Vizita në institucionet korrektuese lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit:

Gjatë vitit janë realizuar vizita në gjitha institucionet korrektuese lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit dhe janë përcjellë raportet me të gjeturat dhe rekomandimet. Mbikëqyrja e rregullt dhe rekomandimet për përmirësim kanë ndikuar pozitivisht për të siguruar se veprimet bëhen në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi dhe kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e efikasitetit të punës së institucioneve korrektuese, gjithashtu monitorimi është bërë edhe përmes shkresave dhe raporteve të ndryshme të hartuara nga Institucionet Korrektuese.

Kërkesat për faljen e dënimit:

Gjithsej gjatë vitit 2023 kemi pranuar dhe përcjell tek organet kompetente 97 kërkesa për faljen e dënimit nga të dënuarit.

Departamenti ligjor ka kontrolluar dhe kompletuar dokumentacionin sipas kërkesave për falje të burgosurve dhe në këtë mënyrë ka siguruar dhe lehtësuar qasjen e të burgosurve për adresimin e kërkesave në Presidencë për realizimin e të drejtës për Falje.

Kërkesa për pezullim dënimit:

Gjatë vitit 2023 kemi pasur 8 kërkesa për pezullim dënimit për arsye të gjendjes jo të mirë shëndetësore. 3 kërkesa janë aprovuar, ndërsa për 5 kërkesa nuk kemi pranuar përgjigje nga gjykata.

Kërkesa për ekstradim dhe transferim:

Gjatë vitit 2023 në Departamentin ligjore janë pranuar dhe janë përcjellë përgjigje për 13 kërkesa në Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë si vijon:

1. Kërkesë për informacion dhe ndihmë juridike të ndërsjellët në çështje penale nga gjykatat Austriake për të burgosurin V.S lidhur me të kaluarën penale.
2. Një kërkesë për transferim të burgosurit M.S në shtetin e Maqedonia e Veriut për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit (Përgjigje me 28.12.2023).
3. Një kërkesë për transferim të burgosurit G.Z në Republikën e Shqipërisë për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit.
4. Një kërkesë për transferim të burgosurit E.V në Republikën e Shqipërisë për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit. Për shkak të zhvillimit të procedurës penale në gjykatat e Kosovës, transferimi i tij nuk është realizuar.
5. Një kërkesë nga autoritetet zvicerane për garanci lidhur me kushtet e burgimit dhe trajtimin e të burgosurit për të ekstraduar në institucione korrektuese në Kosovë (Përgjigje 04.12.2023).
6. Një kërkesë nga autoritetet Zvicerane kapacitetet e pranimit në IK lidhur transferimin e të burgosurit SH.S në institucione korrektuese në Kosovë për mbajtjen e pjesës së mbetur të dënimit (Përgjigje 18.09.2023).
7. Një kërkesë për transferim të burgosurit V.A nga Mbretëria e Belgjikës në Republikën e Kosovës për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit në institucione korrektuese (Përgjigje me 18.09.2023).
8. Një kërkesë nga autoritetet e Mbretërisë së Belgjikës lidhur me kapacitetet e pranimit në IK të Republikës së Kosovës për transferimin e të burgosurit B.G në Institucione korrektuese në Kosovë për mbajtjen e pjesës së mbetur të dënimit (Përgjigje 10.08.2023).
9. Një kërkesë nga autoritetet e Konfederatës Zvicerane lidhur me kapacitetet e pranimit në IK të Republikës së Kosovës për transferimin e të burgosurit B.A në institucione korrektuese në Kosovë për mbajtjen e pjesës së mbetur të dënimit (Përgjigje 04.08.2023).
10. Një kërkesë nga autoritetet e Mbretërisë së Suedisë lidhur me kapacitetet e pranimit në IK të Republikës së Kosovës për transferimin e të burgosurit R.H. në institucione korrektuese në Kosovë për mbajtjen e pjesës së mbetur të dënimit (Përgjigje 31.07.2023).
11. Një kërkesë nga autoritetet e Mbretërisë së Belgjikës lidhur me kapacitetet e pranimit në IK të Republikës së Kosovës për transferimin e të burgosurit F.S. në institucione korrektuese në Kosovë për mbajtjen e pjesës së mbetur të dënimit (Përgjigje 31.07.2023).
12. Një kërkesë nga autoritetet Gjermane për garanci lidhur me kushtet e burgimit dhe trajtimin e të burgosurit për të transferuar në institucione korrektuese në Kosovë (Përgjigje 20.04.2023).
13. I burgosuri B.G me datë 17 mars 2023 është transferuar në Institucione korrektuese në Republikën e Shqipërisë.

Brenda vitit 2023 janë dhënë rekomandime dhe opinione ligjore sipas kërkesave të institucioneve korrektuese dhe për Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Opinionet kanë qartësuar vendimmarrjen për çështjet të ndryshme dhe kanë siguruar pajtueshmërinë me legjislacionin në fuqi .

Përgjigje në rekomandimet e raporteve të avokatit të popullit

Gjatë vitit SHKK është monitoruar nga institucione të autorizuara me ligj e posaçërisht nga Avokati i Popullit - kemi pranuar raportet nga Mekanizimi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (Avokati i popullit) për Qendrën Korrektuese Dubravë, Qendrën e Paraburgimit Prizren dhe për të gjitha raportet janë kthyer përgjigjet me rekomandime lidhur me ndërmarjet e masave dhe përmbushjen e tyre duke ngritur në vazhdimësi kushtet e jetesës dhe trajtimit për të burgosur në institucione korrektuese.

Menaxhimi i parasë publike-buxhetit të SHKK-së

Pasqyra e shpenzimeve të Buxhetit

Buxheti Fillestar	Buxheti Fillestar	Buxheti Aktual	Diferenca Buxheti Aktual - Buxheti Fillestar	Shpenzimet Vjetore	% Me buxhetin Fillestar	% Me buxhetin Aktual
Pagat dhe mëditjet (1662 POZITA)	11,152,826.18	12,602,430.68	1,449,604.50	12,602,430.68	113.00	100.00
Mallrat dhe Shërbimet	4,073,415.00	5,901,865.00	1,828,450.00	5,880,981.63	144.37	99.65
Shpenzimet Komunale	1,145,769.00	995,769.00	(150,000.00)	918,483.25	80.16	92.24
Projektet Kapitale (10)	1,420,800.00	1,270,550.00	(150,250.00)	635,784.59	44.75	50.04
SUBVENCIONE						
Gjithsej :	17,792,810.18	20,770,614.68	2,977,804.50	20,037,680.15	112.62	96.47

IV. PJESA E KATËRT

Prokurimi

Në planin e prokurimit kanë qenë të parapara gjithsej 44 aktivitete.

18 aktivitete të parapara në planin e prokurimit për furnizime, 11 aktivitete të parapara në planin e prokurimit për shërbime, 15 aktivitete të parapara në planin e prokurimit për punë.

Janë zhvilluar gjithsej 54 aktivitete.

Në planin e prokurimit janë tri (3) aktivitete që do të zhvillohen nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 15/67 ku është miratuar lista e artikujve të përbashkët.

Nga AQP janë zhvilluar këto aktivitete:

1. Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimorë;
2. Furnizim me mish dhe produkte të mishit;
3. Furnizim me bylmet, Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor;
4. Furnizim me ujë të pijes;
5. Furnizim me bukë dhe produkte të brumërave;
6. Furnizim me goma verore dhe dimërore;
7. Furnizim me derivate të naftës.
8. Furnizim me pajisje të TI (kompjuterë).

Janë nënshkruar 52 kontrata gjatë vitit 2023.

Menaxhimi i Parave Private të burgosurve (PPB-së)

Gjatë vitit 2023 janë kryer punët dhe detyrat me rëndësi siç janë:

- Pranimi i faturave për shpenzimet e kantinës, transferimi i parave për të burgosurit të cilët janë transferuar në mes të Institucioneve Korrektuese.
- Transferimi i parave nga fondi i mirëbesimit në kodin e kantinës SHKK-së.
- Kërkesa dhe furnizime për kartela telefonike për të burgosur.
- Mbajtur kontakte me MEF-in dhe bankat komerciale të RKS-së.

Gjatë vitit 2023 shuma e parave në llogaritë e mirëbesimit ka qenë: **2,704,209.75 € (kodi 83060).**

Shuma e parave të transferuara nga llogaria e mirëbesimit në kodin e kantinës (kodi i të hyrave për pagesa për të burgosurit) ka qenë: **2,207,292.11 €, (Kodi 89000).**

Shpenzimet e krijuara nga fondi i mirëbesimit për të burgosur:

- Shpenzime për cigare 1,107,829.68 €
- Shpenzime për ushqim 1,025,542.43 €
- Shpenzime për kartela (kabina telefonike, pulla postare dhe kuverta (zarfe) 73,920.00 €

Gjatë vitit 2023 shuma e faturave të kantinës ka arritur në vlerë prej 2,260,501.52 €. (kodi 89000)

Gjatë vitit 2023 shuma e mjeteve të cilat u janë kthyer të burgosurve me rastin e lirimit të tyre përmes llogarive bankare është (53,209.41 €).

Numri i të burgosurve të cilët janë shpërblyer për punën e kryer **Dhjetor 2022- Nëntor 2023** është **mesatarisht 620 të burgosur në muaj, ndërsa vlera e shpërblimit për punën e kryer është 150,598.00 € .**

Ndërsa vlera e paguar Janar –Dhjetor 2023 është si në tabelë:

Nr.	Qëllimi i PO-s	Institucioni	Nr. Biznesit	Llogaria	
1	Pagat e të burgosurve Janar-Dhjetor 2023	QK-Dubravë	07000049	1000-4300-7000-7017	75,242.00 €
2	Pagat e të burgosurve Janar-Dhjetor 2023	Q.P.Prizren	07000051	1000-4300-7000-7114	4,423.00 €
3	Pagat e të burgosurve Janar-Dhjetor 2023	Q.P.Gjilan	07000052	1000-4300-7000-7211	7,003.00 €
4	Pagat e të burgosurve Janar-Dhjetor 2023	Q.P. Lipjan	07000053	1000-4300-7000-7308	6,043.00 €
5	Pagat e të burgosurve Janar-Dhjetor 2023	Q. K. Lipjan	07000050	1000-4300-7000-7405	4,065.00 €
6	Pagat e të burgosurve Janar-Dhjetor 2023	Q. P. Mitrovicë	07000055	1000-4300-7000-7696	4,431.00 €
7	Pagat e të burgosurve Janar-Dhjetor 2023	Q.P. Pejë	07000054	1000-4300-7000-7502	2,883.00 €
	Pagat e të burgosurve Janar-Dhjetor 2023	Q.P. Prishtina	07000056	1000-4300-7000-7793	7,715.00 €
8	Pagat e të burgosurve Janar-Dhjetor 2023	Q.K. Smrekonicë	07000059	1000-4300-7000-7987	15,277.00 €
9	Pagat e të burgosurve Janar-Dhjetor 2023	BSL	07000073	1000-4300-7000-6920	23,516.00 €
	TOTALI				150,598.00 €

Gjatë vitit 2023 lidhur me parat private të burgosurve ka qenë kjo gjendje:

1. Të hyra 2,741,353.81 €
2. Shpenzime 2,207,292.52 €
3. Kthim i mjeteve 53,209.41 €
4. Bartje nga viti 2023 464,810.29 €

V. PJESA E PESTË

Divizioni i Burimeve Njerëzore

Divizioni i Burimeve Njerëzore menaxhon procedurat që kanë të bëjnë me :

- Rekrutimin dhe publikimin e konkurseve sipas planit të personelit dhe buxhetit të paraparë, pranimin e aplikacioneve, verifikimin paraprak, përgatitjen e vendimit të komisionit përzgjedhës vlerësimin e kandidatëve deri në përfundimin e procedurës.
- Përgatitjen e Akt Emërimeve;
- Përgatitjen e dokumentacionit për ID kartelave identifikuese;
- Procedimin në listat e pagave;
- Përgatitja e dosjeve personale në mënyrë fizike dhe elektronike;
- Pushimet vjetore, mjekësore, pa pagesë, pushimet e përdëllimit si dhe për pensionim;
- Përgatitja e vendimeve, vërtetimeve sipas nevojave të stafit;
- Sistemit elektronik për vijueshmëri në punë (SMVP), sistemit të pagave, sistemit për deklarim të pasurisë;
- Vlerësimin vjetor të personelit të Shërbimit Korrektues.

Shërbimi Korrektues i Kosovës me Ligjin për Buxhet për vitin 2023 ka pasur të aprovuar 1662 pozita me masë buxhetor **11,152,826.00 EUR**,

Masa buxhetore e paraparë me ligjin e buxhetit është shpenzuar 100%.

Numri i stafit në muajin dhjetor 2023 në Shërbimin Korrektues ka qenë **1575**, në procedurë të rekrutimit janë 70 pozita kurse pozita të lira janë 17.

Përbërja e personelit të Shërbimit Korrektues:

Staf korrektues të uniformuar.....1323 /84%

Staf civil dhe mbështetës janë252 /16%

Përbërja e personelit të Shërbimit Korrektues sipas gjinisë:

Femra 248 /15.7 %

Meshkuj..... 1327 /84.2 %

Përbërja e personelit të Shërbimit Korrektues sipas nacionaliteteve:

Shqiptar..... 1441 /91.4%

Minoritete134 / 8.5%

Rekrutimet

Në Shërbimin Korrektues të Kosovës në periudhën Janar - Dhjetor 2023, janë rekrutuar gjithsejtë 56 zyrtar, ndërsa në procedurë të rekrutimit janë edhe 70 zyrtar korrektues. Janë avancuar 34 zyrtar;

Degradimet

Gjatë vitit 2023 janë degraduar 2 zyrtar.

Pensionimet

Nga personeli i Shërbimit Korrektues gjatë vitit 2023 kanë qenë gjithsej 13 pensionime të parakohshme, ndërsa në pensionim të rregullt me arritjen e moshës së pensionimit kanë qenë 30 zyrtar.

Masat disiplinore të shqiptuara ndaj personelit

Gjate vitit 2023 Komisioni Disiplinor ka pranuar gjithsej 78 inicime të procedurave Disiplinore prej tyre 46 të ndëshkuar me masë disiplinore ndalim në pagë, 19 raste janë liruar nga përgjegjësia disiplinore, në rivendosje janë kthyer 8 raste, largim nga shërbimi civil janë 5, dy (2) raste janë ulje në pozitë.

Komisioni Ankesave ka trajtuar gjithsej 9 ankesa.

Menaxhimi i sistemit te deklarimit te Pasurisë

Në sistemin e Deklarimit te pasurisë janë regjistrua 19 Zyrtar te Lartë, ndërsa 3 Zyrtar janë larguar nga sistemi.

ZHVILLIMI PROFESIONAL I STAFIT

Nr.	Trajnimi	Numri i trajnimeve	Numri i Pjesëmarrësve	Vendi i Realizimit
1	Trajnimi Biseda për Ndryshim	03	39	AKSP
2	Trajnim Profesional për Zyrtar Korrektues me gjeneratës 43 te SHKK-së	01	46	AKSP
3	Trajnimi "Përdorimi i Mjeteve dhe Metodave për Vlerësim të Rreziku ndaj Radikalizmit	01	07	Hotel Lakeside në Vërmicë
4	Trajnimi Menaxhimi i vijës së parë	01	08	AKSP
5	Trajnimi për negociatorët ne raste pengmarrje	01	20	QKS
6	Trajnimi një ditor "Mbështetje bazike për jetë	01	12	BSL
7	Trajnimi themelor për pistoletën Glock 19	02	14	QKD/AKSP
8	Trajnimi Procedura e Përgjithshme Administrative	01	01	IKAP
9	Trajnimi menaxhimi i performancës së agjencive ekzekutive	01	01	IKAP
10	Trajnimi Luftimi i Diskriminimit, Gjuhës së Urrejtjes dhe Dhunës në baza Gjinore	03	09	AKSP

11	Trajnimi Elementet Bazike të Menaxhimit	02	09	AKSP
12	Trajnimi Sjellja me njerëz dhe Detyrat në vendin e Punës	01	10	AKSP
13	Trajnimi Ngritja e kapaciteteve administrative ne mbrojtjen e te dhënave personale dhe siguria kibernetike"	01	01	IKAP
14	Kursi Shkolla e Stafit Policor dhe Komandës	01	03	AKSP
15	Kursi HAZMAT (Vetëdijesimi me Materie të Rrezikshme)	02	04	AKSP
16	Trajnimin Intervistimi Motivuese	01	17	AKSP
17	Trajnimi; Ndërgjegjësimi , Parandalimi dhe Luftimi i Korrupsionit	01	03	AKSP
18	Trajnimi për Leadership, Linja e parë	01	20	OSCE
19	Trajnimi; "Qasja ndaj Dhunës në baza Gjinore	01	03	AKSP
20	Trajnimi, Identifikimi i hareshëm i shenjave te vetëlëndimeve dhe parandalimi i vetëvrasjeve.	01	36	Hotel Trofta Istog
21	Trajnimi për Integritet	01	01	AKSP
22	Ricertifikim me armë Glock 19	01	652	QKD

Janar-2023

1. Trajnim Profesional për Zyrtar Korrektues me gjeneratës 42 te SHKK-së, trajnim ka përfundon ne datën: 27.01.2023
2. Trajnimi Biseda për Ndryshim është mbajtur nga data:17.01 deri 19.01.2023, trajnimi e kanë përfunduar 14 Zyrtar nga SHKK.

Për muajin Janar janë trajnuar gjithsej **14** Zyrtar të SHKK-së

Shkurt-2023

1. Trajnimi Biseda për Ndryshim është mbajtur nga data:01.02 deri 03.02.2023, trajnimi e kanë përfunduar 11 Zyrtar nga SHKK
2. Trajnimi "Përdorimi i Mjeteve dhe Metodave për Vlerësim të Rreziku ndaj Radikalizmit" është mbajtur nga data: 14.02.2023 deri më 16.02.2023, trajnimin e kanë përfunduar 07 Zyrtar nga SHKK.

Për muajin Shkurt janë trajnuar gjithsej **18** Zyrtar të SHKK-së

Mars- 2023

1. Trajnimi Menaxhimi i vijës së parë ka filluar nga data: 20.02.2023 deri 24.03.2023 trajnimin e kanë vijuar 08 Zyrtar te pozitës Mbikëqyrës të SHKK-së
2. Trajnimi një ditor "Mbështetje bazike për jetë" është mbajtur me datën: 07.03.2023, trajnimin e kanë vijuar 12 Zyrtar Korrektues të BSL
3. Trajnimi themelor për pistoletën Glock 19, është mbajtur nga data: 27.03.2023 deri 31.03.2023 trajnimin e kanë vijuar 07 Zyrtar Korrektues

Për muajin Mars janë trajnuar gjithsej 27 Zyrtar të SHKK-së

Prill- 2023

1. Nga dt:03 deri 05.04.2023, është mbajtur Trajnimi Procedura e Përgjithshme Administrative është mbajtur nga dt:03 deri 05.04.2023 në IKAP, trajnimi e ka vijuar 01 Zyrtar nga SHKK.
2. Nga dt: 24.04.2023 deri 27.04.2023, është mbajtur "Trajnimin për negociatorët ne raste pengmarrje" trajnim është mbajtur nga OSCE, trajnimin janë duke e vijuar 20 Zyrtar nga SHKK.

Për muajin Prill janë trajnuar gjithsej 21 Zyrtar të SHKK-së

Maj- 2023

1. Me datën: 02.05.2023, ka filluar Trajnim Profesional për Zyrtar Korrektues me gjeneratës 43 te SHKK-së, me gjithsejtë 47 kadetë.
2. Nga data: 15.05 deri 17.05.2023 është mbajtur Kursi HAZMAT (Vetëdijesimi me Materie të Rrezikshme) trajnimi e ka vijuar 02 Zyrtar nga SHKK.
3. Trajnimi themelor për pistoletën Glock 19, është mbajtur nga data:22.05.2023 deri 26.05.2023 trajnimin e kanë vijuar 07 Zyrtar Korrektues
4. Trajnimi Luftimi i Diskriminimit, Gjuhës së Urrejtjes dhe Dhunës në baza Gjimore është mbajtur më data:23.05.2023, trajnimin e kanë vijuar 05 Zyrtar nga SHKK.

Për muajin Maj janë trajnuar gjithsej 61 Zyrtar të SHKK-së

Qershor- 2023

1. Me dt:06.06.2023 është mbajtur Trajnimi menaxhimi i performancës së agjencive ekzekutive në IKAP, trajnimi e ka vijuar 01 Zyrtar nga SHKK.
2. Trajnimi Luftimi i Diskriminimit, Gjuhës së Urrejtjes dhe Dhunës në baza Gjimore është mbajtur më data:13.06.2023, trajnimin e kanë vijuar 02 Zyrtar nga SHKK.
3. Trajnimi "Elementet Bazike të Menaxhimit" është mbajtur nga data: 19.06 deri 23.06.2023, trajnimi e kanë përfunduar 04 Zyrtar nga SHKK.

Për muajin Qershor janë trajnuar gjithsej 07 Zyrtar të SHKK-së dhe 46 kadetë te ri

Korrik – 2023

1. Trajnimi Luftimi i Diskriminimit, Gjuhës së Urrejtjes dhe Dhunës në baza Gjimore është mbajtur më data:04.07.2023, trajnimin e kanë vijuar 02 Zyrtar nga SHKK.

Për muajin Korrik janë trajnuar gjithsej 02 Zyrtar të SHKK-së, dhe 46 kadetë te ri

Gusht – 2023

1. Trajnimi "Sjellja me njerëz dhe Detyrat në vendin e Punës" është mbajtur nga data: 07.08 deri 11.08.2023, trajnimi e kanë përfunduar 10 Zyrtar nga SHKK.

Për muajin Gusht janë certifikuar gjithsej 10 Zyrtar nga të SHKK-së, dhe 47 kadetë te ri

Shtator - 2023

1. Trajnimi Ngritja e kapaciteve administrative ne mbrojtjen e te dhënave personale dhe siguria kibernetike" është mbajtur nga data: 19.09.2023 deri 20.09.2023, trajnimi e kanë përfunduar 01 Zyrtar nga SHKK.
2. Nga data: 18.09.2023, kemi filluar me ricertifikim me armë te shkurta Glock 19 me zyrtaret korrektues.

Për muajin Shtator janë trajnuar gjithsej **01** Zyrtar të SHKK-së, dhe **47** kadetë te ri

Tetor – 2023

1. Trajnimin Intervistimi Motivuese është mbajtur nga data: 18.10 deri 20.10.2023, trajnimi e kanë përfunduar **17** Zyrtar nga SHKK.

Për muajin Tetor janë trajnuar gjithsej **17** Zyrtar të SHKK-së, dhe **46** kadetë te ri

Nëntor – 2023

1. Trajnim Profesional për Zyrtar Korrektues me gjeneratës 43 te SHKK-së, me gjithsejtë **46** kadetë, ka përfunduar me datën 07.11.2023.
2. Kursit Shkolla e Stafit Policor dhe Komandës është mbajtur nga data: 28.08.2023 deri 09.11.2023, në AKSP, kursin nga SHKK, e kanë përfunduar **03** Zyrtar Korrektues (NJIK).
3. Trajnimi “Elementet Bazike të Menaxhimit” është mbajtur nga data: 13.11 deri 17.11.2023, trajnimi e kanë përfunduar **05** Zyrtar nga SHKK.
4. Kursin HAZMAT (Vetëdijesimi me Materie të Rrezikshme) është mbajtur nga data 13.11 deri 15.11.2023 në AKSP kursin e kanë përfunduar **02** Zyrtar nga SHKK.
5. Trajnimi Biseda për Ndryshim është mbajtur nga data:20.11 deri 22.11.2023, trajnimi e kanë përfunduar **14** Zyrtar nga SHKK
6. Trajnimin për Leadership, është mbajtur nga OSCE në AKSP-Vushtri nga data 20.11 deri 24.11.2023, trajnimi e kanë përfunduar **20** Zyrtar te nivelit Mbikëqyrës nga SHKK.
7. Trajnimi; Ndërgjegjësimi , Parandalimi dhe Luftimi i Korrupsionit, është mbajtur nga 29 deri 01.12.2023, trajninin e kanë vijuar **03** Zyrtar nga SHKK.
8. Trajnimin; Qasja ndaj Dhunës në baza Gjimore, është mbajtur nga data: 29 deri 01.12.2023, trajninin e kanë vijuar **03** Zyrtar nga SHKK.

Për muajin Nëntor janë trajnuar gjithsej **50** Zyrtar të SHKK-së, dhe **46** kadetë te ri

Dhjetor – 2023

1. Trajnimi Identifikimi i hareshëm i shenjave te vetëlëndimeve dhe parandalimi i vetëvrasjeve, është mbajtur nga data:04 deri 06.12.2023, në Hotel Trofta Istog, trajnimi është mbajtur në mbështetjen e Këshillit të Evropës nga trajnerët e Eulex, trajninin e kanë vijuar **36** Zyrtar Korrektues nga SHKK.

2. Trajnimi për Integritet është mbajtur me datën: 14.12.2023, trajninin e ka vijuar **01** Zyrtar nga SHKK.

Për muajin Dhjetor janë trajnuar gjithsej **37** Zyrtar të SHKK-së

Gjatë vitit 2023, janë mbajtur **21** trajnime dhe janë trajnuar gjithsej, **265** Zyrtarë të SHKK-së, nga data: 02.05.2023 deri 07.11.2023, është mbajtur trajnim profesional për zyrtar korrektues me gjeneratën e 43, trajninin e kanë përfunduar gjithsejtë **46** kadet.

Nga data: 18.09.2023 deri 13.12.2023, janë ri certifikuar për armën Glock 19, gjithsejtë, **652** Zyrtar të SHKK-së.

Trajnimet e mbajtura të stafit të mbështetura nga Ambasada e Amerikës.

Trajnim për “Transportin e te burgosurve” ku kanë marrë pjesë dhe janë certifikuar 16 zyrtarë.

Trajnimi “Ekipi i reagimit emergjent” ku kanë marrë pjesë dhe janë certifikuar 15 zyrtarë.

Trajnimi “Menaxhimi i vijës së parë” ku kanë marrë pjesë dhe janë certifikuar 15 zyrtarë.

Trajnimi për vijën e parë organizuar nga OSBE

“Sistemet e reagimit në Emergjencë” kanë marrë pjesë 28 zyrtarë të Shërbimit Korrektues.

Punëtorit e realizuara të mbështetura nga Këshilli i Evropës;

- Rishikimet dhe editimet e protokolleve të Departamentit të Shëndetësisë së Burgjeve, ku ishin pjesëmarrës 6 zyrtarë,
- Rishikimin e mjeteve dhe programeve të reja ekzistuese dhe zhvillimit të mjeteve dhe programeve të rehabilitimit dhe ri integritit, përfshirë Udhëzimet dhe manualët mbi trajtimin psiko social në

VI. PJESA E GJASHTË

Institutin e Forenzikës Psikiatrike të Kosovës dhe Institutit special në Shtime 18-20 prill 2023, ku ishin pjesëmarrës 3 zyrtarë,

- Terapia Okupacionale, ku ishin pjesëmarrës 4 zyrtarë.

Kontributi i njësisë korrektuese të Eulex-it

Njësia Korrektuese e EULEX ka marrë pjesë aktive në grupet punuese të SHKK-së, ku janë miratuar 19 udhëzime administrative

NJK ka vazhduar ta mbështesë “ Shoqatën e Grave në Shërbim Korrektues të Kosovës” përmes mundësisë të punëtorëve të financuara nga EULEX për Shoqatën e Grave të Shërbimit Korrektues e që kanë pasur për qëllim fuqizimin e personelit korrektues femra, ka vazhduar të bëjë monitorimin e proceseve të rekrutimit të kategorive të ndryshme të stafit të SHKK-së dhe i ka ofruar SHKK-së rekomandime për përmirësimin e procesit të rekrutimit, ka ofruar rekomandime me shkrim sa i përket rishikimit të rregullores së brendshme për kategorizimin e të burgosurve sipas nivelit të rrezikut.

NJK ka vazhduar këshillimin dhe mbështetjen e njësive të veçanta të SHKK-së (Njësia për vlerësim dhe klasifikim të Burgosurve dhe Njësia e Inteligjencës).

Ka organizuar dhe realizuar 5 trajnime në fusha të ndryshme për stafin e Institucioneve Korrektuese siç janë;

- *Trajnimin për Ekstremizmin e Dhunshëm dhe Radikalizmin për një numër të caktuar të stafit në të gjitha institucionet e SHKK-së dhe për kadetët e reja në AKSP,*
- *Trajnim për Sigurinë Dinamike dhe zbatimin e Planit të Dënimit për 45 zyrtarë korrektues të SHKK-së,*
- *Trajnim mbi modelin e zyrtarit të rastit për SHKK-në në Qendrën e Paraburgimit Mitrovicë dhe Qendrën Korrektuese Lipjan,*
- *Trajnimi “Menaxhimi i burgjeve nga aspekti gjinor” dhe ka mbajtur një prezantim mbi qasjen e punës të bazuar në trauma,*
- *Trajnim për identifikimin e faktorëve të rrezikut që lidhen me vetëlëndimin dhe vetëvrasjen*

NJK i ka ofruar SHKK-së këshilla në shumë fusha lidhur me punën e SHKK-së, duke përfshirë administrimin e burgjeve, rehabilitimin e të burgosurve, operativës, menaxhimin e sigurisë, si dhe menaxhimin ekonomik. Ky kontribut ka synuar të krijojë kushte më të mira për SHKK-në për të punuar dhe për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë të burgosurit bazuar në nevojat e tyre individuale.

INXHINIERINGU

Zyra e Inxhinieringut është e fokusuar në realizimin e projekteve dhe punimeve të Institucioneve Korrektuese në përputhje me normat dhe ligjet e aplikueshme për ndërtim në Kosovë dhe ligjin për sanksione penale.

Më poshtë janë shfaqur disa nga aktivitetet e Inxhinieringut;

Projekti	Progresi i projektit
Renovimi i bllokut 2 në Qendren Korrektuese Dubravë	Projekti në progres
Renovimi i kumit ne Qendren Korrektuese Smrekovnicë te blloqet e banimit	Projekt i përfunduar
Renovimi I IML nga dëmet e shkaktuara nga zjarri	Projekt i përfunduar
Mbulimi- Riparimi i kulmit te Bllokut C dhe O në Qendren e Korrtuese në Lipjan	Projekt i përfunduar
Instalimi i kaldasë dhe rregullimi i kulmit te kaldatores në Qendren Korrektuese Lipjan	Projekt i përfunduar
Renovimi nga jashtë dhe punet tjera ndertimore ne Bllokut B në Qendren Korrektuese në Lipjan	Punimet në progress
Asfaltimi dhe ndarja e hapësires per memorialin në Qendrën Korrektuese në Dubravë	Projekti në progress
Rregullimi I ndricimit ne perimetrin e jashtem dhe zavendesimi i poçave me eficencë	Projekt i përfunduar
Instalimi I sistemeve mbrojtese me XR, portave me detektore etj neper institucionet e burgjeve	Perpilimi i specifikave teknike
Renovimi i kulmit dhe punet tjera ndertimore ne Qendren e Paraburgimit ne Mitrovice	Projekt i përfunduar
Furnizimi me material per rregullimin e dyshemesë nëpër Institucionet Korrektuese	Projekt i përfunduar
Ndarja e hyrjes per vizitor dhe per staf ne QP Gjilan -Faza e II-te	Projekti ne progress/Punet finale
Ndertimi I shtëpisë për nëna , vizita të lira dhe punë të tjera ndërtimore	Projekti në progres
Ndërtimi i objekteve per ruajtjen e ushqimit të gjedheve në QK Dubravë	Projekt i përfunduar
Ndertimi i ankesit te stalles nr.2 per gjedhet e komfiskuara nga Dogana e Kosoves	Projekt i përfunduar

Sfidat:

-Projektet e kërkuara nga shteti danez për Qendrën e Paraburgimit në Gjilan

-Mos realizimi i projekteve si pasoje e operatoreve jo te përgjegjshëm ndaj kushteve te kontratës dhe mos realizimit te planit dinamik, ndërprerje e kontratës



“Renovimi dhe izolimi i kulmit ne Q.P.Mitrovicë “
 Është bërë izolimi i kulmit dhe punimi i dyshemeve me epox.



“Renovimi dhe izolimi i kulmit në Q.K.Smrekonicë”
 Është bërë izolimi i kulmit.

“Rregullimi i hapësirës se morgut dhe dhomës se dëshmime ne Institutin e Mjekësisë Ligjore”
 Është bërë renovimi i sallës se morgut, ndërrimi i dritareve, ndërrimi i derës se sallës, si dhe ndarja e instalimeve elektrike ne dhomën e dëshmime ne IML.



Pavijoni D në Qendrën Korrektuese Dubravë

Themelimi dhe funksionimi i Institucionit për trajtimin e personave me nevoja të veçanta është bërë në vitin 2023.

Ky Institucion është themeluar me iniciativën e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues z. Ismail Dibrani, përkrahur nga Ministria e Drejtësisë dhe mbështetur nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ambasada Amerikane, ku shumica e punimeve janë realizuar nga të burgosurit.


Në këtë institucion trajtohen:

- Personat me nevoja të veçanta;
- Personat e moshuar që kanë nevojë për mbështetje dhe kujdes të vazhdueshëm;
- Personat e varur nga substancat e ndryshme;
- Trajtimi i personave me sëmundje kronike që kanë nevojë për kujdes permanent shëndetësorë.

Me funksionalizimin e këtij Institucioni Shëndetësor këtyre personave do tu ofrohet kujdes shëndetësor adekuat dhe profesional.



Inaugurimi i pavijonit D në Qendrën Korrektuese në Dubravë



Pamjet brenda Pavijonit D në Qendrën Korrektuese Dubravë

VII. PJESA E SHTATË

Teknologjia Informative

Sa i përket Teknologjisë Informative të Shërbimit Korrektues gjate vitit 2023 janë realizuar këto projekte dhe aktivitete.

Aktivitetet:

Nr.	Projektet	Aktiviteti
1	Video Seancat Gjyqësore (Sistemi i Audio regjistrimi)për te Burgosurit (Donacion nga ICITAP)	<ul style="list-style-type: none">• Është finalizuar projekti ne tere Institucionet Korrektuese dhe është testuar me KGJK.
2	Menaxhimi i Data bazës SIMB. Dhe ri-trajnimi i stafit të SHKK për përdorim te kësaj data bazë.	<ul style="list-style-type: none">• Menaxhimi i i SIMB ne server virtual se bashku edhe me SQL,IIS.• Ri-trajnimi i stafit ne përdorim te SIMB data bazës ne pjesën e Sigurisë, PPB dhe Edukimi.
3	Zgjerimi i sistemit VOIP për tere SHKK.	<ul style="list-style-type: none">• Zgjerimi i VOIP ne perimetrin e brendshëm te Institucioneve Korrektuese te SHKK.
4	Zgjerimi i komunikimit virtual SKYPE	<ul style="list-style-type: none">• Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve kompjuterike për tere Institucionet Korrektuese te SHKK-se, për komunikim virtual ne mes te burgosurve dhe familjarëve te tyre.
5	Zgjerimi i sub-Domenit i SHKK/MD.GOV	<ul style="list-style-type: none">• Formimi i shfrytëzuesve te rinj dhe futja e tyre ne domen te SHKK/MD-se.• Ndërlidhja me domen duke rritur sigurinë kibernetike dhe ofrimin e shërbimeve online ne kohe reale.
6	Zgjerimi i Rrjetit te internetit ne QK-Dubrave	<ul style="list-style-type: none">• Zgjerimi është bere ne pavijonin D.
7	Siguria Kibernetike	<ul style="list-style-type: none">• Asistimi i stafit te ASHI ne aspektin e Sigurisë Kibernetike për pjesën e SHKK-se.• Vetëdijesimi i stafit te SHKK ne aspektin se si te jemi te mbrojtur nga sulmet eventuale kibernetike ne sistemet qe ata i përdorin.
8	Qendra Operative	<ul style="list-style-type: none">• Vazhdimi i Aktivizimit te pajisjeve te dhuruara nga ICITAP për këtë qendër.• Instalim dhe konfigurim i ID printerit.

9	Konvertimi i QP-Gjilan ne Burg.	<ul style="list-style-type: none"> • Fillimi i Hartimit te specifikave teknike për rrjetin LAN dhe vazhdon deri ne finalizim te burgut.
10	Hartim te Specifikave	<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i specifikave për Uebin e SHKK-se. • Hartimi i specifikave teknike për X-ray skanerin për PAvionin D. • Hartimi i Specifikave për Dyert elektro-mekanike për BSL. • Hartimi i Specifikave për DB SIMB.
11	Projektet për donator te jashtëm	<ul style="list-style-type: none"> • Sistemi i radio komunikimit te dyanshëm. • GPS për veturat e SHKK • Detektimi i telefonave mobil dhe materialeve fero-magnetike • Sistemi sizmik për zona sterile ne
12	Ndryshimi i sistemit operativ për shfrytëzuesit e SHKK	<ul style="list-style-type: none"> • Është bere kalimi nga sistemet e vjetra te windowsit ne Windows 10 e cila ka qene kërkesë e ASHI për shkak te sigurisë kibernetike ne RKS. • Totali i kalimit te tille ka qene 50 raste.

MIRËMBAJTJA:

1. Mirëmbajtja e rrjetit te internetit (lan) ne tere SHKK.
2. Mirëmbajtja e telefonisë fikse duke përfshirë edhe instalime të reja në SHKK.
3. Mirëmbajtja e te gjithë email-ve qeveritar për tere shërbimin korrektues te kosovës.
4. Mirëmbajtja e data bazës te SHKK-se SIMB(sistemi i menaxhimit te burgosurve).
5. Mirëmbajtja e data bazës për te burgosurit e radikalizuar (rrd.rks-gov.net).
6. Mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve kompjuterike ne elektronike e tyre.
7. Mirëmbajtja e domenit te MD/SHKK.
8. Mirëmbajtja dhe Servisimin e pajisjeve kompjuterike.

MARRVESHJET:

Marrëveshja me MD, SHSK dhe SHKK për integrim ne sistemin e MD-se për te burgosurit veprat e te cilëve lidhen me dhunën ne familje.

VIII. PJESA E TETË

Trajtimi i të burgosurve

Rehabilitimi/Risocializimi i të burgosurve dhe përgatitja për ri integrim

Shërbimi Korrektues i Kosovës mbetet i përkushtuar për ti ndihmuar të burgosurit që të ndryshojnë pozitivisht dhe të përgatiten për riintegrim në shoqëri, si individ të përgjegjshëm dhe të dobishëm për shoqërinë dhe rrethin ku do të jetojnë.

